



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 299 Prot.

Shkodër, më 24. 01 . 2025

V E N D I M

Nr. 21 , datë 24.01 2025

"PËR RIORGANIZIMIN E DREJTORISË SË KOMUNIKIMIT, KËRKIMIT SHKENCOR, PROJEKTEVE DHE MARRËDHNIEVE ME JASHTË"


Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38; Statuti i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", neni 17, pika 6, gërma gj) dhe neni 13; Vendimi i Senatit Akademik nr. 282, datë 19. 12. 2024 "Për riaktivizimin e Zyrës së Ekselencës në nivel institucional"; pas propozimit të Rektorit, për riorganizimin e strukturës organizative të kësaj drejtorie, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 24. 01. 2025;

VENDOSI:

1. Riorganizimin e Drejtorisë së Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, nëpërmjet ndarjes në dy drejtori me vete, sipas propozimit në materialin bashkëngjitur.
2. Emërtimi i drejtorive të reja do të jetë si vijon:
 - Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit;
 - Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët;
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof. dr. Tonin GJURAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 299/ Prot.
11

Shkodër, më 24. 01. 2025

Lënda: Relacion bashkëshoqërues i vendimit të SA "Për riorganizim të strukturës së Drejtorisë së Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë".

I. Qëllimi i riorganizimit të strukturës së Drejtorisë së Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë;

Duke pasur parasysh rolin kyç të Drejtorisë së Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në realizimin e misionit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", ky propozim për ndryshimin e strukturës së saj, vjen si një domosdoshmeri për t'iu përgjigjur nevojave dhe sfidave bashkëkohore.

Propozimi bazohet në dy shtylla kryesore: prioritetet strategjike të Universitetit tonë dhe prioritetet kombëtare të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030. Këto dokumente strategjike, të hartuara për të udhëhequr zhvillimin e kërkimit shkencor dhe për të përmirësuar kapacitetet teknologjike dhe inovative në Shqipëri, ofrojnë udhëzime të qarta për zhvillimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Përmes këtij propozimi, synohet të arrihet një qasje më e hapur dhe më dinamike ndaj kërkimit shkencor dhe kërkimit shkencor për të tretë, duke përfshirë zgjerimin e fushave kërkimore dhe fuqizimin e partneriteteve strategjike.

Gjithashtu, nevojitet një fokus i veçantë për të nxitur ndërkombëtarizimin, për të diversifikuar temat e trajtuara në projektet shkencore dhe për të rritur pjesëmarrjen në thirrjet ndërkombëtare për projekte. Me rëndësi të veçantë mbetet edhe angazhimi për të promovuar universitetin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë aktivitete që i japin përparësi studentit, forcimin e bashkëpunimeve me sektorin publik dhe privat dhe rritjen e partneriteteve me aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë për hapjen e universitetit ndaj komunitetit.

Bazuar në këto qëllime dhe sfida, propozohet që struktura aktuale e Drejtorisë të riorganizohet në përputhje me nevojat emergjente dhe objektivat afatgjata të universitetit.


Dokumentacioni Ligjor dhe Strategjik Mbështetës: Në këtë propozim janë marrë parasysh të gjitha aktet dhe dokumentet strategjike që lidhen me arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në vend, përfshirë:

- o **LIGJI. Nr. 80/2015. PËR ARSIMIN E LARTE DHE KERKIMIN, SHKENCOR NE INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTE NE REPUBLIKEN E SHOIPERISE**
- o **Statuti i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"- Mars 2018;**
- o **Strategjia e Kërkimit Shkencor 2022-2026;**
- o **Rregullore e administratës së Rektoratit të USH-së, Nr. 132, 27 Prill 2023;**
- o **LIGJ Nr. 109/2024 PËR SHKENCËN DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në përputhje me këtë kornizë ligjore dhe strategjike, ndryshimet e propozuara synojnë të krijojnë një drejtori që reflekton më mirë nevojat e sotme dhe aspiratat për të ardhmen.

Ky është një hap i rëndësishëm drejt realizimit të vizionit të përbashkët për një universitet më të fortë, më të hapur dhe më të integruar ndërkombëtarisht.

II. Organigrama e re e përbërjes së Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit dhe Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët.



III. Përbushja e kriterëve ligjorë të drejtorive të reja të krijuara nga riorganizimi i Drejtorisë së Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë;

Sipas strukturës së re të miratuar në Senatin Akademik, Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit si dhe Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët, do të ketë konkretisht këtë përbërje:

➤ **Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit, ka në përbërje:**

1. Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve;

2. Zyrën e Ekselencës;

3. Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë

- Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, ka në përbërje një pozicion (Përgjegjës) dhe 2 pozicione- (Specialistë).
- Zyra e Ekselencës është një njësi e re e inkorporuar në këtë drejtori e cila do ketë si funksion dhe qëllim kryesor, rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në USH dhe trajnimin e stafit akademik të USH-së në këtë drejtim.
Zyra e Ekselencës do ketë në përbërje 1 pozicion (Përgjegjës) dhe 2- pozicione (Specialistë).
- Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, ka në përbërje 1 pozicion (Përgjegjës) dhe 2- pozicione (Specialistë).

➤ **Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët, ka në përbërje:**

1. Sektorin e Marrëdhënieve me Studentët;

2. Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun;

- Sektori i Marrëdhënieve me Studentët, ka në përbërje një pozicion- (Përgjegjës) dhe 2 pozicione- (Specialistë).
- Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, ka në përbërje 1 pozicion (Përgjegjës) dhe 2- pozicione (Specialistë).

Referuar Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr. 27 datë 29. 12. 2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, pika 13, është e përcaktuar se: *“Në nivel Insitucional, strukturat me personel ndihmës akademik me karakter administrativ dhe personel administrativ organizohen në drejtori, sektorë dhe zyra, ku secila drejtori nuk mund të ketë më pak se dy sektorë apo zyra, secili sektor apo zyrë, nuk mund të ketë më pak se tre specialistë.”*

Mbështetur në Udhëzimin e cituar më lart, struktura e re e përbërjes së drejtorive të krijuara nga riorganizimi, përmbush kriteret ligjore të funksionimit.

IV. Efektet financiare:

Emërtimi	nr i orëve që i pakësohen	Pagë/orë	Total efekti financiar
Përgjegjës i Zyrës së Ekselencës (Prof As ose Dr)	30	1295	38,85
Specialist i Zyrës së Ekselencës Dr	20	940	18,80
Specialist i Zyres së Ekselences Dr	20	940	18,80
Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun (Prof As ose Dr)	50	1295	64,75
Specialist i Marrëdhënieve me Biznesin (për t'u punësuar)			1,585,248
Përgjegjës i Marrëdhënieve me Publikun promovohet nga specialist)			36,17
Specialist Grafik dizajner	20	705	14,10
TOTALI			1,776,725

V. Detyrat funksionale të drejtorive/ sektorëve;

A. DREJTORIA E KËRKIMIT SHKENCOR DHE NDËRKOMBËTARIZIMIT

1. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, ka në përbërje një pozicion (Përgjegjës) dhe 2 pozicione- (Specialistë) – mbeten detyrat e përcaktuara në “Rregullore e administratës së Rektoratit të USH-së”, Nr. 132, 27 Prill 2023

2. Sektori i Ndërkombëtarizimit (ish Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë)- ka në përbërje 1 pozicion (Përgjegjës) dhe 2- pozicione (Specialistë) - mbeten detyrat e përcaktuara në “Rregullore e administratës së Rektoratit të USH-së”, Nr. 132, 27 Prill 2023

3. Zyra e Ekselencës do ketë në përbërje 1 pozicion (Përgjegjës) dhe 2- pozicione (Specialistë), të gjithë staf akademik. Zyra e Ekselencës do të ketë si qëllim kryesor

- realizimin e trainimeve të ndryshme të stafit akademik në funksion të përmirësimit të cilësisë së kërkimit shkencor në UNISHK

- lehtësimin e punës kërkimore – shkencore të stafit akademik nëpërmjet shpërndarjes së informacioneve për thirrje për konferenca, botime, përditësim mbi arritjet shkencore etj.

- trainime me tema të gjera ndaj komuniteteve të vecanta në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, arsimit dhe shkencës,

B. DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE STUDENTËT

1. **Sektori i Marrëdhënieve me Studentët, ka në përbërje një pozicion- (Përgjegjës) dhe 2 pozicione- (Specialistë).** - mbeten detyrat e përcaktuara në “Rregullore e administratës së Rektoratit të USH-së”, Nr. 132, 27 Prill 2023. Njëri nga specialistët, Specialisti ALUMNI vjen nga stafi akademik, me normë të reduktuar.

2. **Sektori i Marrëdhënieve me Publikun** ka në përbërje 1 pozicion (Përgjegjës) dhe 2- pozicione (Specialistë). Kjo shtyllë, që më parë mbulohej vetëm nga një specialist i marrëdhënieve me publikun, tani kthehet në Sektor, ku përvec përgjegjësit, shtohen 2 (dy) specialistë si më poshtë:

Përgjegjës: Koordinator i marrëdhënieve dhe komunikimit me publikun , ndjekja e aktiviteteve që organizohen në njësitë përbërëse të Universitetit,

Specialist X: Grafik dizajner; hartues i materialeve vizive për promovimin e aktiviteteve të UNISHK- poster, fletëpalsoje, broshura etj, (staf akademik me normë te reduktuar)

Specialist Y: siguron bashkëpunimin me bizneset si dhe menaxhon organizimin e eventeve të universitetit

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Tonin Gjuraj

